



FEDERATA E SHENJËTARISË SPORTIVE E KOSOVËS  
SPORTSKA STRELJAČKA FEDERACIJA KOSOVA  
KOSOVO SHOOTING SPORT FEDERATION  
Adresa: Rr. "Agim Ramadani" Nr. 43. Shtëpia e Sporteve Prishtinë, Kosovë.  
Tel: +381 (0) 38 244 473  
e-mail: [info@fshsk.org](mailto:info@fshsk.org), [gezim.hazrolli@fshsk.org](mailto:gezim.hazrolli@fshsk.org)

---

---

**R R E G U L L O R E**  
**PËR PUNËN E KUVENDIT TË FEDERATËS SË**  
**SHENJËTARISË SPORTIVE TË KOSOVËS**

Prishtinë 11.11.2022

Në bazë të Nenit 18 dhe 20 pika 1.4 të Statutit të Federatës së Shenjëtarisë Sportive të Kosovës, të aprovuar me datë 11.11.2022 (në tekstin e mëtejme – Statuti), Kuvendi i Federatës së Shenjëtarisë Sportive të Kosovës (në tekstin e mëtejme - FSHSK), në seancën e Kuvendit të mbajtur më datë 11.11.2022 miratoi këtë.

## **RREGULLORE**

### **PËR PUNËN E KUVENDIT TË FEDERATËS SË SHENJËTARISË SPORTIVE TË KOSOVËS**

#### **Neni 1.**

Me këtë Rregullore të Punës, në përputhje me Statutin e Federatës së Shenjëtarisë Sportive të Kosovës (në tekstin e mëtejme: Federata), përcaktohet mënyra e punës së organeve dhe shërbimit profesional, në përgatitjen, zhvillimin dhe përfundimin e seancave të Kuvendit të Federatës së Shenjëtarisë Sportive të Kosovës (në tekstin e mëtejme: Kuvendi).

#### **Neni 2.**

Seancat e Kuvendit mbledhen, mbahen dhe zhvillohen në përputhje me nenin 19. të Statutit.

#### **Përgatitjet për seancën e Kuvendit**

#### **Neni 3.**

Materialet e tekst propozimit për seancat e Kuvendit, në konsultim me Kryetarin e Federatës, i përgatit Sekretari i Përgjithshëm dhe miratohen nga Këshilli Drejtues i Federatës.

Tekst propozimin e Statutit dhe tekst propozimin e Vendimit për ndryshimet dhe plotësimet e Statutit të Federatës, Këshilli Drejtues i miraton pasi që të jenë zhvilluar diskutimet me klubet anëtare të FSHSK-së, prej së paku 30 ditësh. Në rast se klubet anëtare nuk marrin pjesë në diskutim, nënkuptohet se pajtohen me rezultatin e diskutimit të zhvilluar, përkatësisht, me propozimin e dërguar nga Këshilli Drejtues.

Materialet tjera për Kuvendin, Këshilli Drejtues dhe Kuvendi, si rregull i shqyrtojnë paraprakisht pa debat publik.

#### **Neni 4.**

Kryetari i Kuvendit të Federatës, përkatësisht Këshilli Drejtues, shpall zgjedhjet për organet e Kuvendit më se largu 60 ditë para mbajtjes së seancës zgjedhore të Kuvendit dhe i njofton me shkrim të gjithë anëtarët e Federatës për:

- kohën e mbajtjes së seancës zgjedhore të Kuvendit të FSHSK-së.
- mënyrën e propozimit dhe përmbajtjen e propozimeve të kandidatëve për organet e Federatës.
- afatet kohore për propozim të kandidatëve dhe afatet tjera për kryerjen e aktiviteteve zgjedhore.

Këshilli Drejtues i Federatës do të përcaktoj propozimin e materialit për seancën e Kuvendit zgjedhor së paku 15 ditë para seancës zgjedhore të Kuvendit dhe do të propozon;

- rendin e ditës, verifikon listën e anëtarëve të cilët sipas statutit kanë të drejt ti delegojnë përfaqësuesit e tyre në esencën e Kuvendit dhe të vendos për listën e propozimeve të kandidatëve për zgjedhje në organet e Federatës

#### **Neni 5.**

Thirrjet për seancë të Kuvendit, me rendin e ditës, propozim materialet e miratuara, sipas rendit të ditës për punë, si dhe **flet autorizimin**, shërbimi profesional i Federatës i përgatit dhe i dërgon tek anëtarët e Federatës, së paku 10 ditë para ditës së përcaktuar për seancën e Kuvendit.

#### **Neni 6.**

Anëtarët e verifikuar, në përputhje me Statutet e tyre, i shqyrtojnë materialet e dorëzuara për mbledhjen e Kuvendit dhe zgjedhin, caktojnë, ose emërojnë përfaqësuesin e tyre të autorizuar për mbledhjen e planifikuar të Kuvendit, e cila konfirmohet nga plotësimi dhe nënshkrimi i **flet autorizimit** në emër të përfaqësuesit të zgjedhur, të caktuar ose të emëruar.

#### **Neni 7.**

Kandidatin për Kryetar dhe anëtarët e organeve të tjera të Federatës, mundet t'i propozojë çdo anëtar i rregullt dhe i verifikuar i Federatës.

#### **Neni 8.**

Kandidatët për funksionet zgjedhore, mundin të propozohen nga radhët e garuesve, punonjësve të shenjëtarisë, sportistëve, si dhe nga kategoritë e tjera të qytetarëve, prej të cilëve pritët të japin një kontribut të rëndësishëm në zhvillimin e shenjëtarisë me pjesëmarrjen e tyre në punën e organeve të Federatës, në mënyrë profesionale, financiare ose mënyra tjera.

#### **Neni 9.**

Shërbimi profesional i Federatës, me kohë i merr të gjitha masat për përgatitjen dhe rregullimin e hapësirës për mbajtjen e seancës së Kuvendit, duke përcaktuar vendet e uljes për Kryesinë, komisionet, anëtarët e Kuvendit, mysafirët, përfaqësuesit e mediave dhe të tjerët; cakton personin përgjegjës për protokoll, rregullimin teknik të hapësirës, përdorimin e elementëve të skenografisë, pajisjeve audio dhe video që do përdoren në takim.

#### **Neni 10.**

Pak para fillimit të seancës së Kuvendit, përfaqësuesi i Shërbimit Profesional i pret dhe i pranon anëtarët e Kuvendit dhe personat e tjerë të ftuar, mbanë të dhënat e tyre; i rregullon, nëse është e nevojshme, materialet shtesë, fletëvotimet dhe kartonët e votimi PËR; si dhe u ofron ndihmë në përgatitjen për seancë.

### **Mbajtja e mbledhjeve dhe marrja e vendimeve në seanca**

#### **Neni 11.**

Kuvendin e Federatës, në pajtim me Nenin 30. të Statutit, në bazë të parimit të delegimit, e përbëjnë nga dy përfaqësues të autorizuar, nga secili klub anëtar, me statusin e anëtarit të rregullt të Federatës, të anëtarësuar jo më vonë se gjashtë muaj para seancës së Kuvendit, dhe sipas listës së anëtarëve të verifikuar nga KD në seancën para mbledhjes së Kuvendit.

Përfaqësuesit e anëtarëve të Federatës dhe anëtarët e nderit të Federatës, mundin të marrin pjesë në punën e Kuvendit, pa të drejtë vote.

Mbledhjet e Kuvendit janë publike.

Përrjashtimisht, seancat e Kuvendit ose shqyrtimi i çështjeve të caktuara në seancat e Kuvendit, mundin të jenë të mbyllura për publikun, për të cilën gjë vendos Kuvendi.

### **Neni 12.**

Çdo anëtar i Kuvendit, ose përfaqësues i autorizuar i një klubi anëtar të rregullt të Federatës, do të paraqet flet autorizimin e plotësuar dhe vulosur nga organi kompetent sipas nenin 6. të kësaj Rregulloreje, e cila dëshmon se bartësi i flet autorizimit është i deleguari i anëtarit të rregullt të Federatës, në pajtim me Nenin 18. të Statutit.

### **Neni 13.**

Çdo anëtar i Kuvendit ka të drejtë të marrë pjesë në seancën e Kuvendit, të propozojë ndryshimet dhe plotësimet në agjendën e Kuvendit, të propozojë shqyrtimin e çështjeve nga juridiksioni i Kuvendit dhe të marrë pjesë në shqyrtimin e çështjeve dhe në vendimmarrje, në pajtim me rendin e ditës të miratuar nga seanca e Kuvendit.

### **Neni 14.**

Në pjesën preliminare të seancës, para miratimit të rendit të ditës, Kryetari i Federatës, si Kryesues, apo Kryetar i Kryesisë së Kuvendit, u propozon anëtarëve të pranishëm të Kuvendit, sipas tij, ose me propozimin e një anëtari tjetër të Kuvendit, që të zgjedhin Kryesinë e punës dhe Komisionin verifikues, si dhe caktimin e procesmbajtësit dhe dy verifikues të procesverbalit.

Në të njëjtën mënyrë, nga paragrafi i mësipërm i këtij Neni, në Kuvendin Zgjedhor, Kuvendi gjithashtu zgjedh edhe Komisionin zgjedhor.

### **Neni 15.**

Organet punuese të përmendura në nenin e mësipërm të kësaj Rregulloreje, pas zgjedhjes dhe caktimit të tyre, marrin vendet e tyre. Pastaj, Komisioni Verifikues, bazuar në grumbullimin e flet autorizimeve, verifikojnë numrin e anëtarëve të pranishëm, ndërsa Kryesuesi i njofton anëtarët e Kuvendit me dispozitat e Statutit dhe Rregulloren e punës së Kuvendit, lidhur me mënyrën e punës dhe vendimmarrjes në seancën e Kuvendit dhe i informon ata për rrjedhën e planifikuar të seancës.

### **Neni 16.**

Sipas raportit të Komisionit Verifikues, dhe varësisht nga numri i anëtarëve të pranishëm, nëse janë plotësuar kushtet nga Neni 16.

Kuvendi mundet të punojë në mënyrë të plotfuqishme, nëse më shumë se gjysma e përfaqësuesve të klubeve anëtarë të rregullt janë të pranishëm, kurse vendosë me shumicën e votave të përfaqësuesve të pranishëm.

Në mungesë të numrit të mjaftueshëm të anëtarëve të përmendur në nenin 19. Pika 8, paragrafi 2 Statutit, Kryesuesi arrin në përfundimin se seanca nuk mund të mbahet.

### **Neni 17.**

Pasi të merren vendimet e përmendura në nenin e mësipërm, me propozimin e Kryesuesit ose të një anëtari tjetër të Kuvendi, Kuvendi vendos për mënyrën e votimit.

Me marrjen e vendimit të përmendur në paragrafin e mësipërm, Kryetari zyrtarisht hapë seancën, pas së cilës, hapë diskutimin mbi rendin e ditës, pas së cilës, ai i vë në votim – së pari propozimet e mundshme për ndryshim në rendin e ditës, dhe pastaj rendin e ditës, të propozuar më parë, me ndryshimet dhe plotësimet eventuale – në tërësi.

### **Neni 18.**

Pas miratimit të rendit të ditës, Kuvendi konfirmon zyrtarisht vendimin për zgjedhjen e Kryesisë së punës, Komisionin verifikues zgjedhor dhe emërimin e procesmbajtësit dhe dy mbikëqyrësit e

procesverbalit. Për çdo pikë tjetër në rend dite, apo për çdo propozim-vendim, ose material, pas paraqitjes hyrëse të përfaqësuesve, Kryesuesi hapë debat, në të cilin mund të marrin pjesë të gjithë anëtarët e Kuvendit dhe të gjithë personat e ftuar.

Lidhur me materialet më komplekse dhe aktet normative, diskutimi zhvillohet pas prezantimit hyrës të përfaqësuesve (referuesve), dhe vendoset me rregull në tri faza: për material në parim, në mënyrë të detajuar dhe në tërësi, por së pari votohet për ndryshimet / amendamentet dhe më pas për tekstin themelor të materialit në tërësi.

#### **Neni 19.**

Përveç nëse vendoset ndryshe nga Kuvendi, fjalimi i anëtarëve, përveç fjalisë hyrëse, fjalisë për njoftim / informim dhe referimit rreth materialit referues që do të diskutohet, diskutimet mund të zgjasin maksimum 5 minuta, ndërsa folësi mund të flasë-diskutojë vetëm një herë për të njëjtën çështje.

Në rast se një folës diskuton në një temë që nuk është në rend të ditës, nëse fyen, apo pengon punën e Kuvendit, Kryesuesi mund t'i japë atij vërejtje.

Nëse folësi, të cilit i tërhiqet vërejtja, vazhdon me sjellje të njëjta, sipas paragrafit të mësipërm nga ky nen, Kryesuesi mundet t'ia merr fjalën dhe nëse vazhdon me sjellje të tillë, Kryesuesi do ta largojë atë nga mbledhja.

#### **Neni 20.**

Në pajtim me Statutin, Kuvendi merr vendime me votim publik, të hapur, ose të fshehur, dhe vendimet merren nëse votojnë për të, shumica e anëtarëve të rregullt, të pranishëm në Kuvend.

Për votim publik "të hapur, ose të fshehur", vendosë Kuvendi, për çdo rast konkret, nëse ndryshe nuk është përcaktuar me këtë Rregullore, ose me Statut.

#### **Neni 21.**

Në seancën zgjedhore të Kuvendit, Kryetarin e Federatës, anëtarët e Këshilli Drejtues dhe Këshillin Mbikëqyrës të Federatës, e zgjedhin të gjithë anëtarët e pranishëm të Kuvendit, sipas rregullit me votim të fshehtë.

Nëse në listat zgjedhore gjendet numër më i madh i kandidatëve, të cilët do të zgjedhën, janë të zgjedhur ata kandidatë, të cilët kanë marr votat e shumicës së anëtarëve të pranishëm në Kuvend.

Nëse në listat zgjedhore ka më shumë kandidatë sesa numri i kandidatëve për t'u zgjedhur, ata kandidatë që kanë fituar numër më të madh të votave, zgjedhën anëtar të organeve të Kuvendit të FSHSK-së.

#### **Neni 22.**

Procesverbalet e çdo seance të Kuvendit përmbajnë: kohën e fillimit të seancës, numrin e anëtarëve të pranishëm të Kuvendit, rrjedha e seancës, përmbledhja e diskutimeve, vendimet e marra, me rezultatet e votimit për të gjitha propozimet, koha e përfundimit të seancës, dhe të dhëna të tjera të rëndësishme për funksionimin e Federatës.

### **Puna pas përfundimit të seancës së Kuvendit**

#### **Neni 23.**

Në fund të seancës së Kuvendit, procesmbajtësi është i detyruar të hartojë raportin e procesverbalit, brenda 15 ditëve. Procesverbali i nënshkruar, dorëzohet për verifikim tek verifikuesit e procesverbalit. Nëse verifikuesit e procesverbalit kanë vërejtje në tekstin e dorëzuar të procesverbalit, procesmbajtësi e harmonizon tekstin e procesverbalit, i cili pastaj

nënshkruhet nga procesmbajtësi dhe verifikuesit e procesverbalit dhe dorëzohet tek Sekretari i Përgjithshëm i Federatës.

#### **Neni 24.**

Vendimet dhe aktet normative të miratuara nga Kuvendi, të cilat nuk janë pjesë përbërëse e procesverbalit, i bashkëngjiten procesverbalit dhe nënshkruhen nga kryetari i Kuvendit.

#### **Neni 25.**

Procesverbali i seancës së Kuvendit, me tekstin e dokumenteve dhe vendimeve të miratuara, i dorëzohet anëtarëve të Federatës, jo më vonë se 30 ditë nga data e mbajtjes së seancës së Kuvendit.

Anëtarët e Federatës mund të dorëzojnë, brenda 30 ditëve nga data e pranimit të procesverbalit, vërejtje mbi tekstin e procesverbalit, me propozime për korrigjimin e gabimeve të mundshme në tekstin e procesverbalit, tek shërbimi profesional i Federatës.

Nëse vërejtjet dhe propozimet nga paragrafi i mëparshëm janë të arsyeshme, procesmbajtësi do t'i përfshijë ato në tekstin e ndryshuar dhe të plotësuar të procesverbalit.

Teksti përfundimtar i procesverbalit, verifikohet nga Kuvendi i Federatës, në seancën e ardhshme.

#### **Neni 26.**

Për çështjet që nuk rregullohen me këtë Rregullore të Punës, Statuti i Federatës është i zbatueshëm drejtpërdrejtë, ose Kuvendi vendosë drejtpërsëdrejti për këto çështje, në përputhje me Ligjin dhe Statutin.

#### **Neni 27.**

Kjo Rregullore do të hyj në fuqi në datën e miratimit të saj.

Prishtinë, 11.11.2022

Kryetari i FSHSK-së  
Gëzim Hazrolli

